Miresevini ne fakultetin tone

Për më shumë informacion në lidhje me ne klikoni në menu djathtas>

HISTORIKU

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit u krijua ne 27.07.2007, më Vendimin e Keshillit të Ministrave për ndarjen e Fakultetit të Bujqësisë dhe krijimin e tre fakulteteve të reja në UBT”, mbi bazën e Departamentit të Teknologjisë Agroushqimore, krijuar në vitin 1998 (Fakulteti i Bujqësisë), që përfshinte Seksionin e Kimisë dhe Biologjisë, të ardhur nga shkrirja e Departamentit Nderfakultetor të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Edukimi ne Shkencat dhe Teknologjine Ushqimore (ShTU) ne Universitetin Bujqesor te Tiranes ka filluar ne vitet 1960, nepermjet disiplinave teknologjike, si:

- Konservimi dhe perpunimi i produkteve bujqesore,
- Teknologjia e perpunimit te fruta-perimeve,
- Teknologjia e perpunimit te rrushit (enologjia),
- Teknologjia perpunimit te produkteve blegtorale.

Pas viteve 1990, veç disiplinave te mesiperme, u shtuan edhe disiplina te tjera, si:

- Teknologjia ushqimore
- Kontrolli higjieno-sanitar i ushqimeve me origjine blegtorale
- Mikrobiologjia dhe bioteknologjia ushqimore,

qe jane zhvilluar ne departamente te ndryshme te UBT, pa perfillur ketu nje numer disiplinash biologjike teorike e zbatuese, te lidhura ngushte me shkencat dhe teknologjine ushqimore.

Fakulteti i Bioteknologjise dhe Ushqimit pergatit inxhiniere agroushqimore, bioteknologe dhe specialiste te ushqimit e sigurise ushqimore, te afte te punojne ne te gjitha etapat e e zinxhirit ushqimor.

Fakulteti i Bioteknologjise dhe Ushqimit, perbehet nga 3 njesi baze:

1. Departamenti i Bioteknologjise Agroushqimore, qe jep:

- Diplome te ciklit te pare (Bachelor) ne:

Inxhinieri agroushqimore, ne dy profile:

a) Profili 1 : Teknologji agroushqimore

b) Profili 2 : Vreshtari-enologji

- Diplome e ciklit te dyte ne:

Inxhinieri agroushqimore (Master i shkencave) ne dy profile :

a) Profili 1 : Teknologji agroushqimore

b) Profili 2 : Vreshtari-enologji

Bioteknologji ushqimore (Master i shkencave)

Cilesia dhe siguria ushqimore (Master profesional)

- Diplome e ciklit te trete (doktorate) ne :

Shkencat dhe bioteknologjia ushqimore

2. Departamenti i Biologji-Kimise, qe
nuk jep diplome, por zhvillon disiplinat e kimise se pergjithshme e inorganike, te kimise organike, te kimise fizike, te kimise analitike, te biologjise, te zoologjise etj, ne fakultetet e UBT.

3. Qendra e Kerkimeve te
Ushqimit (QKU)

Qendra e Kerkimeve te
Ushqimit (QKU) eshte qender kerkimore shkencore, njesi baze, ne perberje te Fakultetit te Bioteknologjise dhe Ushqimit. Ajo kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi ne fushen e teknologjise agroushqimore, bioteknologjise dhe ushqimit dhe merr pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë.